



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA  
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE/  
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË

Dt .07.06.2024 Nr.

Në mbështetje të nenit 8, paragrafit 1 dhe 2 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.90/2010), nenit 5, pika c) të Ligjit për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës Nr.03/L-068 ,Ligji nr.08/L-197 për Zyrtaret Publik , rregullores nr.05/2022 për procedurat konkurruese dhe pranimit për nëpunësit administrativ dhe mbështetës , Komuna e Fushë Kosovës shpallë:

**K O N K U R S**

Nr.	Niveli	Pozita	Vend i Lirë	Numri i Pozitave
1	IP	Shtëpiak	Vend i lirë	1

**I. Aplikacionit i bashkëngjiten dokumentet, si vijon:**

- Formulari i aplikimit i plotësuar (merret në Komunë, në Arkiv ose në web. të Komunës),
- Rezumeja personale (CV),
- Dokumenti personal (letërnjoftim ose pasaportë),
- Diplomat e kualifikimit (ose certifikatat), certifikatat në vend të diplomës duhet të jenë të noterizuara te Noteri dhe jo më të vjetra se gjashtë muaj. Çdo certifikatë e diplomës më e vjetër se gjashtë muaj nga data e diplomimit nuk do të merret parasysh,
- Certifikata që nuk jeni nën hetime,
- Dëshmi të përvojës (nëse ka).

**Koeficienti : 3.76**

**II. Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve të stafit administrativ dhe mbështetës :**

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara me akte juridike që e rregullojnë fushën e arsimit para universitar, Ligjit Nr.03/L-068 , Ligjit për zyrtarët publik nr.08/L-197, Ligjit te punës nr.03/L-212, rregullores nr.05/2022 për procedurat konkurruese dhe pranimit për nëpunësit administrativ dhe mbështetës.

**III. Kriteret e kualifikimit për Shtëpiak :**

- Të posedoj diplomë të shkollës se mesme.
- Aftësi komunikuese dhe te jetë i gatshëm për punë ne grup;
- Te mos kenë dosje penale (te vertetur me certifikatë nga gjykata kompetente);
- Është e preferueshme te ketë se paku 1 vit përvojë pune ne punët dhe detyrat e shtëpiakut



#### IV. Detyrat dhe përgjegjësitë :

1. Kujdeset për mirëmbajtjen e ndërtesës së IP në pjesët e brendshme dhe të jashtme;
2. Bën mirëmbajtjen e instalimit elektrik, ujit, inventarit dhe pajisjeve të tjera;
3. Në rast të defekteve të mëdha, mban kontakte me serviset e specializuara dhe asiston me rastin e riparimeve;
4. Bën kyçjen dhe çkyqjen e nxemjes qendrore dhe të gjeneratorit elektrik, duke mbajtur edhe evidencën e derivateve.
5. Mban Evidencën, Kontrollon dhe monitoron rezervuarin e derivateve dhe lendeve djegëse të cilat mund të jenë të vendosura në lokacionet e IP;
6. Bën mirëmbajtjen e oborrit dhe përkujdesët për lulet brenda dhe përreth ndërtesës së IP;
7. Kryen edhe punë të tjera sipas nevojës dhe kërkesës që momenti i imponon..

#### V. Afati dhe mënyra e aplikimit:

Konkursi mbetet i hapur **15 ditë** nga dita e shpalljes së konkursit në mjetet e informimit publik, duke filluar nga data e publikimit më **07.06.2024 deri me 21.06.2024**.

Për intervistë do të ftohen ata kandidatë që i plotësojnë kushtet sipas akteve ligjore të lartcekura. Lista e ngushtë e aplikantëve që ftohen për intervistë si dhe orari i intervistës do të publikohen në web faqen e Komunës së Fushë-Kosovës.

<https://kk.rks-gov.net/fushekosove/>

Të gjitha dokumentet duhet të jenë kopje dhe ato nuk kthehen, ndërsa origjinalet do të kërkohen me rastin e intervistimit.

Aplikacioni i kompletuar me të gjitha dokumentet e kërkuara duhet të dorëzohet në Komunë përmes zyrës pritëse në objektin e Komunës së Fushë-Kosovës.

**Vërejtje:** Pas aplikimit kandidatët duhet të ruajnë dëshminë e aplikimit e cila është e domosdoshme për fazat e tjera të procedurave të konkursit.

Adresa: Objekti i Komunës, rruga Tahir Zemaj nr.2, Fushë-Kosovë.

Drejtori i Drejtorisë për Arsim

Fatlum Berisha

